URDHËR
Nr. 301, datë 27.11.2024

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PROCEDURAT DHE KRITERET NË LIDHJE ME MARRËVESHJET KUADËR PËR NDARJEN E KAPACITETEVE TË INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE"[1]

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, neneve 39, 40, 41, 42, 43, 44 deri 45, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", të nenit 70, të ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006, "Për ratifikimin e 'Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare"',

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Për procedurat dhe kriteret në lidhje me marrëveshjet kuadër për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen administratorët e infrastrukturës dhe Autoriteti Rregullator Hekurudhor për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE
PËR PROCEDURAT DHE KRITERET NË LIDHJE ME MARRËVESHJET KUADËR PËR NDARJEN E KAPACITETEVE TË INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton procedurën dhe kriteret që ndiqen për lidhjen e marrëveshjeve kuadër.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllim të kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. "Kapaciteti kuadër" nënkupton kapacitetin infrastrukturor të dhënë sipas një marrëveshjeje kuadër;
2. "Deklarata e kapacitetit të kuadër" nënkupton një përmbledhje të kapacitetit kuadër të dhënë në linjat e një rrjeti të caktuar dhe një tregues të vëllimit dhe natyrës së kapacitetit të disponueshëm në

[1] *Kjo rregullore përafron plotësisht me:*
- Rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2016/545, datë 7 prill 2016, "Mbi procedurat dhe kriteret në lidhje me marrëveshjet kuadër për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore" (tekst me rëndësinë e ZEE), Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian OJ L 94, 8.4.2016, p. 1–11.

linja të tilla, dhe mund të përfshijë një pamje grafike, me qëllim të informimit të mundshëm të kërkuesve për marrëveshje kuadër;

3. "Periudha kohore" nënkupton periudhën kohore të specifikuar në një marrëveshje kuadër brenda së cilës një ose disa itinerare treni synohen të ndahen sipas procedurës së orarit;

4. "Periudha e kontrollit" nënkupton një periudhë kohore prej dy orësh maksimumi siç përcaktohet nga administratori i infrastrukturës, për krahasimin e kapacitetit të ndarë kuadër dhe kapacitetit të mbetur të lirë, me qëllim të informimit të kërkuesve të mundshëm për marrëveshjet kuadër, për tregimin e të dhënave për kapacitetin kuadër dhe kapacitetin në dispozicion.

Neni 3

Deklarata e kapacitetit kuadër

1. Administratori i infrastrukturës harton një deklaratë kapaciteti kuadër që tregon për çdo seksion të linjës për periudhën e kontrollit dhe, nëse është e aplikueshme sipas llojit të shërbimit, informacionin e mëposhtëm:

a) kapacitetin kuadër të dhënë tashmë dhe numrin e itinerareve të trenave;

b) kapacitetin ende të disponueshëm për lidhjen e marrëveshjeve kuadër për infrastrukturën për të cilat marrëveshjet kuadër janë përfunduar tashmë;

c) kapacitetin maksimal të disponueshëm për marrëveshjet kuadër për çdo seksion të linjës, aty ku është e aplikueshme.

2. Deklarata e kapacitetit kuadër respekton konfidencialitetin tregtar.

3. Në përputhje me nenin 43, pika 9, të ligjit nr. 142/2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", më poshtë Kodi, administratori i infrastrukturës përfshin një deklaratë të kapacitetit kuadër në deklaratën e rrjetit ose siguron një lidhje në deklaratën e rrjetit në një faqe interneti publike ku ajo deklaratë e kapacitetit kuadër, ose si minimum, është vënë në dispozicion natyra e përgjithshme e secilës marrëveshje kuadër të lidhur. Neni 28, pika 1, e Kodit në lidhje me tarifat dhe gjuhët e deklaratës së rrjetit zbatohet gjithashtu për deklaratën e kapacitetit kuadër.

4. Administratori i infrastrukturës përditëson deklaratën e kapacitetit kuadër jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të një marrëveshjeje kuadër, një ndryshimi thelbësor të saj ose anulimit të saj. Ai e bën atë informacion të disponueshëm në një mënyrë që respekton konfidencialitetin tregtar.

Neni 4

Përafrimi i deklaratave të rrjetit

Administratorët e infrastrukturës përafrojnë deklaratat e tyre të rrjetit me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe publikojnë deklaratën e kapacitetit të kuadër në datën e ndryshimit të orarit të parë pas publikimit të rregullores në Qendrën e Botimeve Zyrtare.

Neni 5

Shpërndarja e kapaciteteve kuadër

1. Administratori i infrastrukturës fton kërkuesit e mundshëm të paraqesin kërkesa për marrëveshje kuadër brenda një afati vjetor ose shumëvjeçar në zbatim të pikës 7, nenit 43, të Kodit. Pasi të ketë mbaruar afati përkatës, trajton pa vonesë kërkesat e paraqitura. Nëse administratori i infrastrukturës fton për marrëveshje kuadër brenda një afati shumëvjeçar, ai do të publikojë afatet vjetore deri në të cilat do të përpunojë kërkesat e marra pas afatit shumëvjeçar pa vonesa të panevojshme.

2. Kur administratori i infrastrukturës nuk vendos një afat vjetor ose shumëvjeçar dhe merr një kërkesë për të lidhur ose modifikuar një marrëveshje kuadër, ai merr hapa të arsyeshëm për të informuar kërkuesit e tjerë të mundshëm për qëllimin e tij për të lidhur një marrëveshje kuadër dhe ju lë atyre një deri në katër muaj kohë për të kthyer përgjigje. Administratori i infrastrukturës mund të vendosë të mos informojë kërkuesit e tjerë të mundshëm nëse merr një kërkesë për një modifikim të vogël të një marrëveshjeje kuadër që nuk ndikon në marrëveshje të tjera kuadër.
Administratori i infrastrukturës vendos për kërkesat për marrëveshje kuadër pa vonesë.

3. Nëse për të njëjtin kapacitet paraqiten dy ose më shumë kërkesa të reja për një marrëveshje kuadër, administratori i infrastrukturës i shqyrton dhe vendos për to njëkohësisht.

4. Nëse një marrëveshje kuadër që do lidhet ose modifikohet në thelb ka të bëjë me linjat hekurudhore të mallrave kufitare, administratori i infrastrukturës informon palën kufitare të paktën një muaj përpara lidhjes ose modifikimit thelbësor të marrëveshjes kuadër.

5. Pavarësisht nga një vendim për lidhjen e marrëveshjeve kuadër, administratori i infrastrukturës vendos mbi baza jodiskriminuese dhe, kur është e aplikueshme, me miratimin paraprak të Autoritetit Rregullator Hekurudhor, që të mos ofrojë marrëveshje kuadër për të gjitha linjat që janë deklaruar të mbingarkuar në përputhje me nenin 47, pika 1, e Kodit. Administratori i infrastrukturës tregon linjat ku nuk ofron marrëveshje kuadër në deklaratën e kapacitetit kuadër përpara se të ftojë kërkuesit të paraqesin kërkesa për marrëveshje kuadër për linjat e tjera në përputhje me paragrafin 1. Miratimi i Autoritetit Rregullator Hekurudhor, aty ku është e aplikueshme, është i vlefshëm për një periudhë maksimale prej dy vjetësh dhe nuk mund të rinovohet automatikisht.

6. Administratori i infrastrukturës arsyeton vendimin e tij për të refuzuar, për të lidhur ose për të modifikuar një marrëveshje kuadër. Arsyet i jepen me shkrim kërkuesit që ka kërkuar përfundimin ose modifikimin.

Neni 6
Përfundimi i marrëveshjeve kuadër

1. Përpara përfundimit të një marrëveshjeje të re kuadër ose zgjerimit ose rritjes së konsiderueshme të kapacitetit kuadër të një marrëveshjeje kuadër ekzistues, administratori i infrastrukturës merr parasysh, ndër të tjera, sa vijon:

a) sigurimin e përdorimit optimal të kapacitetit të infrastrukturës në dispozicion, duke përfshirë përdorimin e rrjeteve të tjera, duke marrë parasysh kufizimet e planifikuara të kapacitetit;

b) nevojat legjitime tregtare të kërkuesit ku kërkuesi ka treguar se ka qëllimin dhe aftësinë aktuale për të përdorur kapacitetin e kërkuar në marrëveshjen kuadër;

c) nevojat e udhëtarëve, sektorit të mallrave dhe investitorëve, përfshirë entet shtetërore dhe entet e tjera publike dhe private;

ç) sigurimin e aksesit jodiskriminues në infrastrukturë dhe duke marrë parasysh disponueshmërinë e objekteve dhe shërbimeve përkatëse të ofruara në këto objekte për aq sa ky informacion vihet në dispozicion të administratorit të infrastrukturës;

d) financimi i administratorit të infrastrukturës dhe zhvillimi i ardhshëm i rrjetit;

dh) promovimi i efikasitetit në funksionimin e infrastrukturës dhe aq sa është e mundur objektet e ndërlidhura, duke përfshirë mirëmbajtjen, përmirësimin dhe rinovimin e planifikuar;

e) kërkesat e kapacitetit të korridoreve hekurudhore ndërkombëtare të mallrave;

ë) sigurimin e menaxhimit proporcional, të synuar, transparent, të drejtë dhe me burime të mjaftueshme të rrjetit;

f) dështimi i mëparshëm, nëse ka, për të përdorur kapacitetin kuadër dhe arsyet për atë dështim siç përcaktohet në nenin 11, pikat 2 dhe 3, të kësaj rregulloreje;

g) kriteret e përparësisë që zbatohen për caktimin e itinerareve në procedurën e caktimit të orarit, siç përmendet në nenin 47, të Kodit dhe deklaratat e infrastrukturës së mbingarkuar;

gj) nëse është e aplikueshme, nevoja për të siguruar performancën financiare afatgjatë të transportit publik të ofruar sipas një kontrate shërbimi publik.

Administratori i infrastrukturës publikon në deklaratën e rrjetit, përveç artikujve të renditur në pikat "a" deri në "gj", zërat e tjerë që synon të marrë parasysh.

2. Një marrëveshje kuadër duhet të përmbajë sa vijon:

a) dispozitat që lejojnë kërkesat për modifikimin e kapacitetit kuadër në rrethanat e parashikuara në nenet 8–11 dhe 13 të kësaj rregulloreje;

b) dispozitat që lejojnë kërkesat për modifikimin e kapacitetit kuadër në rastin e ndryshimeve të përhershme të infrastrukturës që janë të nevojshme për të siguruar përdorimin më të mirë të infrastrukturës hekurudhore;

c) dispozitat që lejojnë dorëzimin ose zhvendosjen e kapacitetit kuadër mbi baza vullnetare.

Ai nuk duhet të përmbajë dispozita që do të pengonin administratorin e infrastrukturës, ku kapaciteti është i disponueshëm, t'i japë të drejta aksesi një kërkuesi të ndryshëm në një ose më shumë linja të rrjetit të administratorit të infrastrukturës.

3. Kërkuesit mund të kërkojnë që kapaciteti kuadër i ndarë në përputhje me marrëveshjen kuadër të fillojë në çdo kohë të caktuar, por jo më vonë se pesë vjet nga data e kërkesës. Administratorët e infrastrukturës nuk i refuzojnë këto kërkesa kur periudha kohore e nevojshme përpara marrjes së shërbimit, justifikohet me një nga arsyet e mëposhtme:

a) Marrëveshja kuadër është një parakusht për financimin e mjeteve lëvizëse që nevojiten për një shërbim të ri;

b) ka nevojë të plotësohet autorizimi i mjeteve lëvizëse siç referohet në pikën "a";

c) mënyrën se si planifikohet fillimi i funksionimit të pikave të transportit ose terminaleve të ngarkimit ose hapja e një pjese lidhëse të infrastrukturës;

ç) duhet të investohet në infrastrukturë ku kapaciteti i rritur nuk është ende i disponueshëm;

d) një dispozitë në një kontratë shërbimi publik ekzistues.

Administratori i infrastrukturës ose kërkuesi mund të kërkojë nga Autoriteti Rregullator të miratojë një periudhë më të gjatë se ajo e përmendur në fjalinë e parë të nënparagrafit të parë.

Autoriteti Rregullator mund të japë miratimin e tij për arsye të tjera nga ato të përcaktuara në pikat "a" deri "gj" të nënparagrafit të parë. Kapaciteti i dhënë sipas marrëveshjes kuadër, por i pashfrytëzuar, si pasojë e kohës së nevojshme përpara fillimit të shërbimit, mbetet i disponueshëm për përdorim nga kërkuesit e tjerë.

4. Kërkesa për marrëveshje kuadër nuk refuzohet me arsyetimin se administratori i infrastrukturës e ka marrë kërkesën pas afatit të përmendur në nenin 5, pika 1, por trajtohet sipas procedurës së ardhshme mbi baza jodiskriminuese në përputhje me nenin 5. Nëse administratori i infrastrukturës fton kërkuesit e mundshëm të paraqesin kërkesa për marrëveshje kuadër brenda një afati shumëvjeçar dhe nëse i merr këto kërkesa pas këtij afati, ai i trajton ato ose brenda një afati vjetor në përputhje me nenin 5, pika 1, ose në përputhje me nenin 5, pika 2.

Për kërkesat që plotësojnë kriteret e parashikuara në paragrafin 3, të këtij neni, data e pranimit të kërkesës për marrëveshje kuadër nuk merret parasysh për caktimin e kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër. Kjo nuk zbatohet për kërkuesit të cilëve u janë caktuar tashmë kapacitete të tjera kuadër ose itinerare treni në linjën përkatëse.

Neni 7

Marrëveshje për një afat kohor

Administratori i infrastrukturës bie dakord për një marrëveshje kuadër kohore me kërkuesin rast pas rasti dhe afati kohor duhet të jetë sa më afër që të jetë e mundur me periudhën e kontrollit në mënyrë që të lehtësojë caktimin e kapacitetit kuadër përkatës. Afati kohor pasqyron nevojat e shërbimit të trenit.

Afati kohor është deri në 24 orë. Në raste të jashtëzakonshme, me kërkesë të kërkuesit dhe me miratim paraprak nga Autoriteti Rregullator, administratori i infrastrukturës bie dakord për një afat kohor prej më shumë se 24 orësh.

Në rastin e një afati kohor prej më shumë se dy orësh, administratori i infrastrukturës cakton kapacitetin kuadër sa më afër që të jetë e mundur me një periudhë kontrolli dyorëshe.

Afatet kohore sipas një marrëveshjeje kuadër ose sipas marrëveshjeve të ndryshme kuadër mund të mbivendosen. Palët në një marrëveshje kuadër mund të bien dakord për një frekuencë shërbimi.

Neni 8

Tavanet për ndarjen e kapaciteteve kuadër

1. Administratori i infrastrukturës ndan çdo periudhë 24-orëshe në periudha kontrolli jo më të gjata se dy orë secila. Me rastin e alokimit të kapacitetit kuadër, administratori i infrastrukturës cakton afatet kohore për periudhat e kontrollit.

2. Kur administratori i infrastrukturës shpërndan kapacitet kuadër prej jo më shumë se 70% të kapacitetit maksimal në çdo periudhë të caktuar kontrolli në një linjë, ai vendos të mos zbatojë nenin 9, pikat 3 deri 6, nenin 10 dhe nenin 11, pika 1, në lidhje me ato periudha kontrolli.

Kapaciteti maksimal llogaritet në bazë të lëvizjeve ekzistuese dhe të planifikuara të trenave dhe numrit të parashikuar të trenave në linjën përkatëse. Administratori i infrastrukturës publikon në deklaratën e rrjetit metodologjinë e tij për llogaritjen e kapacitetit maksimal për qëllimin e këtij paragrafi.

3. Kur kërkohet miratimi paraprak i marrëveshjeve kuadër nga Autoriteti Rregullator, në përputhje me nenin 41, të Kodit, ministria që mbulon transportet mund të vendosë të mos zbatojë asnjë ose të gjithë paragrafin 2 dhe nenet 9, pika 3 deri në pikën 6 dhe nenin 10.

Neni 9

Koordinimi në rast të kërkesave kontradiktore për marrëveshje kuadër për çdo kohë pas përfundimit të afatit kohor

1. Nëse administratori i infrastrukturës ndeshet me konflikte ndërmjet marrëveshjeve kuadër ekzistuese dhe kërkesave për marrëveshje kuadër të reja ose të modifikuara ose ndërmjet kërkesave për marrëveshje të reja kuadër, zbatohen parimet e procedurës së koordinimit për kërkesat e itinerarit të parashikuara nga neni 46, pikat 3 dhe 5, e Kodit.

2. Administratori i infrastrukturës përpiqet nëpërmjet koordinimit të parë të sigurojë përputhjen më të mirë të mundshme të kërkesave konfliktuale ose të një kërkese dhe marrëveshjeve kuadër ekzistuese.

3. Kur marrëveshjet kuadër ekzistuese dhe kërkesat për marrëveshje të reja kuadër ose kërkesat për modifikimin e marrëveshjeve nuk mund të rakordohen pas një raundi të parë koordinues, pas refuzimit nga palët e interesuara të zgjidhjes së propozuar nga administratori i infrastrukturës, ky i fundit vlerëson këto kërkesa dhe, nëse është e nevojshme, marrëveshjet ekzistuese kuadër, duke marrë parasysh kriteret e parashikuara në nenin 10, pikat 2 deri në 4.

4. Mbi bazën e vlerësimit në përputhje me paragrafin 3, administratori i infrastrukturës kryen një raund të dytë të koordinimit. Nëse raundi i dytë i koordinimit ka rezultuar i pasuksesshëm dhe nëse marrëveshja kuadër e kërkuar parashikon një përdorim më të mirë të infrastrukturës, administratori i infrastrukturës kërkon modifikimin e kapacitetit kuadër të dhënë sipas marrëveshjeve kuadër ekzistuese.

5. Nëse raundi i dytë i koordinimit ka rezultuar i pasuksesshëm dhe nëse një marrëveshje kuadër e kërkuar nuk parashikon një përdorim më të mirë të infrastrukturës sesa një ose disa marrëveshje kuadër ekzistuese konfliktuale, administratori i infrastrukturës e refuzon kërkesën.

6. Administratori i infrastrukturës refuzon një marrëveshje kuadër të kërkuar, nëse të ardhurat shtesë të krijuara nga lidhja e marrëveshjes së re kuadër nuk kompensojnë së paku ndëshkimet e mundshme, siç përmendet në nenin 13, sipas modifikimit të përmendur në paragrafin 4 të këtij neni.

7. Nëse nuk është e mundur të plotësohen kërkesat për marrëveshje kuadër për arsye të mungesës aktuale ose të pritshme të kapacitetit të infrastrukturës, administratori i infrastrukturës deklaron se seksioni i infrastrukturës në fjalë është i mbingarkuar në përputhje me nenin 47, të Kodit.

Neni 10

Koordinimi i kërkesave kontradiktore për itineraret e trenave sipas marrëveshjeve kuadër gjatë procedurës së planifikimit

1. Kur, për shkak të një konflikti me një marrëveshje kuadër ekzistuese, kërkesat për itineraret e trenave nuk mund të plotësohen në përputhje me planifikimin e përcaktuar në nenin 45, të Kodit, administratori i infrastrukturës zhvillon një raund të parë koordinues në përputhje me nenin 46, të Kodit. Ky koordinim bëhet edhe në rastet kur palët në marrëveshjen kuadër vullnetarisht kanë hequr dorë ose modifikojnë afatet e tyre kohore. Nëse administratori i infrastrukturës nuk mund të rakordojë kërkesat, ai vlerëson marrëveshjet kuadër dhe kërkesat për itinerareve e trenave në përputhje me kriteret e parashikuara në paragrafët 2 dhe 3.

Nëse, në bazë të këtyre kritereve, itineraret e kërkuar të trenave sigurojnë një përdorim më të mirë të infrastrukturës dhe nëse të ardhurat shtesë të krijuara nga shpërndarja e këtyre itinerareve të trenave kompensojnë së paku gjobat e mundshme të përmendura në nenin 13 dhe të shkaktuara nga një modifikim ose përfundim i një ose disa marrëveshjeve kuadër ekzistuese, administratori i infrastrukturës kërkon modifikimin e marrëveshjeve kuadër ekzistuese për periudhën e ardhshme.

2. Administratori i infrastrukturës merr parasysh kriteret e mëposhtme:

a) një modifikim nuk rrezikon qëndrueshmërinë e modelit të biznesit të kërkuesit që zotëron kapacitetin kuadër ose modelin ekonomik të një kontrate shërbimi publik;

b) një modifikim nuk rrezikon qëndrueshmërinë e modelit të biznesit të administratorit të infrastrukturës nëse ai menaxhon vetëm linjën në fjalë;

c) Marrëveshja kuadër ka një performancë më të ulët kur vlerësohet kundrejt kritereve prioritare të aplikuara për caktimin e itinerareve në procedurën e caktimit të orarit në përputhje me rregullat për shpërndarjen e kapaciteteve siç përmendet në nenet 40, 47 dhe 49, të Kodit;

ç) kapaciteti total i mbajtur ose i kërkuar nga një kërkues në linjën në fjalë është i rëndësishëm;

d) nevojat legjitime tregtare të kërkuesit ku kërkuesi ka demonstruar qëllimin dhe aftësinë e tij aktuale për të përdorur kapacitetin e kërkuar në marrëveshjen kuadër;

dh) kohëzgjatja e shërbimit, duke përfshirë shtrirjet në rrjete të tjera, të njërës prej kërkesave konfliktuale është dukshëm më e shkurtër se ajo e tjetrës;

e) kohëzgjatja e mbetur e marrëveshjes kuadër ose e planit të biznesit është e shkurtër dhe i gjithë ose një pjesë e madhe e investimit është shlyer.

Ministria përgjegjëse për transportet përcakton një rend të rëndësisë së këtyre kritereve në kuadrin për ndarjen e kapaciteteve siç referohet në nenin 40, të Kodit.

3. Në varësi të miratimit nga Autoriteti Rregullator, administratori i infrastrukturës vendos kritere shtesë për ato të renditura në pikat "a" deri "e". Nëse administratori i infrastrukturës i jep kritereve pesha të ndryshme, peshimi i kritereve miratohet nga Autoriteti Rregullator.

4. Për trafikun ndërkufitar, administratorët e infrastrukturës në fjalë vendosin bashkërisht të aplikojnë kritere shtesë dhe të ndryshojnë peshën e tyre.

5. Me përjashtim nga paragrafët 1, 2 dhe 3, administratori i infrastrukturës vendos që në rastin e kërkesave konfliktuale për itinerarin e trenave, rregullat e shpërndarjes së kapaciteteve siç referohen në nenin 40 të Kodit, duke përfshirë kriteret e përparësisë të aplikuara sipas procedurës vjetore të caktimit të orarit, në përputhje me nenet 47 dhe 49 të Kodit, zbatohet si për kërkesat e itinerarit sipas një marrëveshjeje kuadër, ashtu edhe për të gjitha kërkesat e tjera për itinerare. Nëse administratori i infrastrukturës vendos kështu dhe nëse kërkesat kontradiktore nuk mund të zgjidhen pas një koordinimi të parë siç përmendet në paragrafin 1, ai zbaton gjithashtu ato rregulla të shpërndarjes së kapaciteteve siç referohen në nenin 40, të Kodit, duke përfshirë përparësinë, kriteret e përcaktuara në përputhje me nenet 47 dhe 49, të Kodit. Nëse administratori i infrastrukturës vendos të zbatojë këtë paragraf, ai e bën këtë transparent në marrëveshjen kuadër të rënë dakord.

Neni 11

Përshtatja e kapaciteteve kuadër në marrëveshjen kuadër

1. Administratori i infrastrukturës rishikon periodikisht marrëveshjen kuadër me kërkesën për të marrë në konsideratë kapacitetin kuadër. Kërkuesit informojnë pa vonesë administratorin e infrastrukturës për çdo qëllim të përhershëm për të mos përdorur të gjithë ose një pjesë të kapacitetit të kuadër.

2. Nëse gjatë planifikimit vjetor, kërkuesi nuk kërkon itinerare treni në bazë të marrëveshjes kuadër, administratori i infrastrukturës redukton kapacitetin kuadër në përputhje me rrethanat aktuale. Kjo ndodh nëse kërkuesi justifikon pa vonesë mos kërkimin e itinerareve të trenit dhe arsyet e dhëna janë jashtë kontrollit të kërkuesit.

3. Administratori i infrastrukturës vendos dhe publikon në deklaratën e rrjetit kërkesat në lidhje me proporcionin e kapacitetit kuadër që do të përdoret nga palët në marrëveshjet kuadër.

Ky raport do të jetë i përshtatshëm duke marrë parasysh kapacitetin e përdorur në linjë. Autoriteti Rregullator mund të kërkojë modifikimin e proporcionit nëse nuk është kështu.

Kur pala në marrëveshje nuk synon të përdorë atë pjesë të kapacitetit kuadër gjatë një periudhe më shumë se një muaji, ajo duhet të informojë menjëherë administratorin e infrastrukturës dhe të paktën një muaj më parë për këtë.

Kur pala në marrëveshje nuk përdor të gjithë ose një pjesë të kapacitetit kuadër për një periudhë më shumë se një muaj dhe nuk e ka informuar administratorin e infrastrukturës të paktën një muaj përpara, administratori i infrastrukturës redukton kapacitetin e alokuar kësaj pale për periudhën aktuale, përveç rasteve kur një mos përdorim i kapacitetit është për arsye jashtë kontrollit të saj. Administratori i infrastrukturës zvogëlon kapacitetin kuadër të caktuar për këtë palë për kohën pasardhëse.

Administratori i infrastrukturës i ofron një kërkuesi kapacitetin kuadër pavarësisht nga e drejta e mundshme e palës në marrëveshje për të kërkuar atë kapacitet në përputhje me dispozitat për kërkesat *ad-hoc* të referuara në nenin 48, pika 1, e Kodit.

4. Kur i ofron kapacitet të ri kuadër një kërkuesi, administratori i infrastrukturës merr në konsideratë çdo mos shfrytëzim kapaciteti kuadër ose për të kërkuar itinerare treni në bazë të një marrëveshjeje kuadër dhe arsyet për të.

Neni 12

Bashkëpunimi në ndarjen e kapaciteteve kuadër në më shumë se një rrjet

1. Administratorët e infrastrukturës që kanë të bëjnë me një shërbim që kalon në shtetet fqinje kufitare duhet të sigurojnë sa më shumë që të jetë e mundur që:

a) nëse një ose më shumë marrëveshje kuadër janë lidhur për një shërbim të tillë treni, afatet kohore të kërkuara përputhen me ato të rënë dakord sipas marrëveshjes kuadër ose të kërkuara sipas saj dhe kapaciteti i parashikuar i disponueshëm sipas çdo marrëveshjeje kuadër përputhet me njëri-tjetrin;

b) gjatë planifikimit të itinerareve të trenave, itinerareve e trenit përputhen me njëra-tjetrën.

Kur kërkohet ose është në funksionim një marrëveshje kuadër për një shërbim treni që kalon më shumë se një rrjet, me kërkesë të kërkuesit, administratorët e infrastrukturës do të caktojnë një me synimin për të koordinuar kërkesat për marrëveshje kuadër ose kërkesa. për të modifikuar marrëveshjet kuadër.

2. Nëse nuk është e mundur të përputhen afatet kohore dhe itinerareve e trenave, Administratorët e infrastrukturës do të koordinohen për të ofruar një alternativë të përshtatshme ose do të arsyetojnë me shkrim kur nuk mund të ofrohet alternativë e përshtatshme. Kërkuesi duhet të informojë administratorët e infrastrukturës që kanë marrë kërkesën për çdo kërkesë të mundshme ose aktuale për një marrëveshje tjetër kuadër në lidhje me të njëjtin shërbim treni.

Gjatë koordinimit, administratorët e infrastrukturës marrin parasysh kufizimet e kapacitetit si ato që rrjedhin nga punimet e mirëmbajtjes, sapo të bëhen të njohura.

3. Për qëllimin e zbatimit të kësaj rregulloreje, administratorët e infrastrukturës bashkëpunojnë në përputhje me nenin 41 të Kodit, duke përfshirë kur një ose më shumë prej tyre nuk propozojnë marrëveshje kuadër dhe kur shoqërohen për qëllime kapaciteti alokimi.

Neni 13

Sanksionet

1. Nëse njëra palë kërkon të parashikohen sanksione në marrëveshjen kuadër në përputhje me nenin 43, pika 6 e Kodit, ajo nuk refuzon sanksionet e krahasueshme të kërkuara nga pala tjetër.

2. Marrëveshja kuadër nuk vendos sanksione në një nivel që tejkalon kostot, humbjet direkte dhe shpenzimet (duke përfshirë humbjen e të ardhurave) të shkaktuara në mënyrë të arsyeshme ose që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të shkaktohen nga pala e zhdëmtuar si pasojë e modifikimit ose përfundimit të marrëveshjes. Pala e dëmshpërblyer ndërmerr hapa të arsyeshëm për të parandaluar ose reduktuar modifikimin e marrëveshjes, ose për të parandaluar përfundimin e saj ose për të zvogëluar ndikimin e saj, dhe për të rikuperuar çdo kosto, humbje dhe shpenzim ose për të zbutur ndryshe kostot, humbjet direkte dhe shpenzimet (përfshirë humbja e të ardhurave).

3. Administratori i infrastrukturës nuk kërkon që pagesa e sanksioneve të tejkalojë kostot administrative për modifikimin ose përfundimin e marrëveshjes kuadër në asnjë nga rastet e mëposhtme:

a) shkaku i modifikimit ose përfundimit të marrëveshjes ishte jashtë kontrollit të kërkuesit dhe administratori i infrastrukturës ishte informuar pa vonesë për këtë;

b) kërkuesit iu refuzua një kërkesë plotësuese për kapacitet kuadër, pa të cilën shërbimi i parashikuar i trenit nuk ishte i zbatueshëm;

c) administratori i infrastrukturës rialokon itinerare të trenave dhe kapacitetin kuadër në një mënyrë që humbjet e shkaktuara nga modifikimi ose përfundimi i marrëveshjes kuadër janë rikuperuar tashmë.

4. Marrëveshja kuadër nuk përmban një dispozitë që heq sanksionin në rastin kur kërkuesi kërkon veçmas kapacitet tjetër nga kapaciteti i anuluar. Sanksionet nuk kërkohen nëse një modifikim përfshin vetëm një ndryshim margjinal në kapacitetin e rënë dakord.

5. Me kërkesë të Autoritetit Rregullator, administratori i infrastrukturës siguron dëshmi për kryerjen e pagesave të sanksioneve në kohë.

Neni 14

Derogimi

Nëse një administrator infrastrukture nuk propozon marrëveshje kuadër dhe nuk ka marrëveshje të tilla në funksion, nenet 1 deri në 11 dhe neni 13 nuk zbatohen për rrjetin e tij. Një deklaratë për këtë publikohet në deklaratën e rrjetit.

Neni 15

Moszbatimi i dispozitave të caktuara

Për marrëveshjet kuadër të lidhura përpara datës së miratimit, nuk zbatohen nenet 6, pikat 2, 7, 8, 9, 10, 11 ose 13 për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Me përjashtim nga paragrafi 1, nuk do të kenë opsionin e përmendur në fjalinë e parë për amendamentet e marrëveshjeve kuadër, të cilat janë rënë dakord pas datës së miratimit dhe që do të përfshinte një rritje të kapacitetit të ndarë kuadër ose një zgjatje të kohëzgjatjes së marrëveshjen kuadër.